

# Evropa Perëndimore

përpiluar nga redaktorët

Ligjet gjithnjë e më të ashpra kundër “ciganëve” | “Ndjekjet e ciganëve” në Saksoni | Franca dhe Holanda: galerat dhe “ndjekjet pagane” | Asimilimi i detyruar: siujdhesa Iberiane

➤ Periudha gjatë së cilës romët kishin letrat e sjelljes së sigurt, të lëshuara nga sundimtarët në dispozicionin e tyre ishin plotësisht me lëmoshë dhe vendbanim në vendet e Evropës qendrore dhe perëndimore por që zgjatën vetëm për një kohë të shkurtë. Nga fillimi i shekullit të 16-të e më tej, më shumë e më shumë ligje radikale shpiten në përjashtimin e tyre, dëbimin dhe persekutimin e hapur, që arrin kulmin në vrasjet e organizuara të romëve. Shpesh, sikurse ishte rasti në Spanjë apo Perandorinë e Shenjtë Romake, mizoria e persekutimit arriti kulmin e saj vetëm në shekullin e 18-të.



III. 1.

Ekzekutimi i anëtarëve të bandës së “Ciganëve” të akuzuar për plaçkitje në Giessen, Hesse.

(nga Fraser 1992, f. 178)

## PARATHËNIE

Shumë shpejt pas mirëprimitjes së parë dhe relativisht miqësore në Evropë, situata filloi të ndryshojë për romët.

Për kishën, kryesisht praktikantët e supozuara mjekësore “jo të krishterë” të “Ciganëve”, falli dhe “magjitë” tjera ishin një ngacmim i vazhdues-

hëm. Punëtorët lokal dhe gidat mendonin se të ardhurat dhe monopoli i tyre ishin kërcënuar dhe prandaj u përpoqën t’i largonin konkurrentët e padëshiruar nga rruga e tyre në çdo mënyrë. Për shkak të shpenzimeve të ngritura dhe reputacionit gjithnjë e më të keq të romëve shumë shpejt qytetet nuk dëshironin t’i toleronin më.

Ndaj sundimtarëve të Epokës Moderne romët dukeshin të jenë vagabondë jo produktiv nën sundimin e askujt, të cilët nuk do t’i adaptoheshin rendit ekzistues shoqëror. Si rrjedhim, shumica e sundimtarëve nxorën ligje anti-“Cigane”. Edhe nëse ata ndërmerrnin strategji të ndryshme, qëllimi i tyre i përbashkët ishte t’i zhdukun “Ciganët”. [III. 1, 2]

Ligjet gjithnjë e më të ashpra kundër “ciganëve”

“Ndjekjet e ciganëve” në Saksoni

Franca dhe Holanda: galerat dhe “ndjekjet pagane”

Asimilimi i detyruar: siujdhesa Iberiane

### Von den Ziegeunern.

Derjenigen halben/so sich Ziegeuner nennen/vnd hin vnd her in die Land ziehen/sol per Edictum publicum allen Ständen des Reichs/durch ons bey den Pflichten/damit sie ons vnd dem H Reich verwandt seyn / ernstlich gebotten werden/d; sie hinfür dieselben Ziegeuner/nach dem man glaublich anzeigung hat / d; sie Erfahrer/Aufspäher/vnd Verkundschaffter der Christen Land seyen/in oder durch ihr Land/Gebiet vnd Oberkeit nit ziehen/handeln/noch wandeln lassen/noch inen des Sicherheit oder Geleyd geben. Vnd daß sich die Ziegeuner darauff/ hie zwischen Ostern nechstkünftig auß den Landen Teutscher Nation thun/sich der enteussern/ vund darinn nicht finden lassen. Dann wo sie darnach betretten/ vnd jemand mit der That gegen ihnen zu handeln fürnehmen würde / der sol daran nicht gefreucht/noch vnrecht gethan haben/wie dann solches vnser Mandat weiter inhalten wirdt.

III. 2

Dekreti nga Maksimilian I, si në “Reichsabschied” (rezolutën e Reich) të vitit 1500:

“... sol ... ernstlich gebotten werden, daß ... sich die Ziegeuner darauff hie zwischen Ostern nechstkünftig auß den Landen Teutscher Nation thun, sich der enteussern, und darinn nicht finden lassen. Dann wo sie darnach betretten, und jemand mit der That gegen ihnen zu handeln fürnehmen würde, der soll daran nit gefrevelt, noch unrecht gethan haben ...” (“... do të urdhërohen seriozisht që ... Ciganët të largohen nga territoret e Shtetit Gjerman deri në Pashkët, të mbahen jashtë dhe mos të gjenden brenda, sepse nëse ata do të futeshin brenda dhe ndokush do të donte t’i lëndonte, ai nuk do të ishte në gabim ...”)

(nga Gronemeyer / Rakelmann 1988, f. 48)

Ata të cilët do të mund të ofronin shërbime ndonjëherë kishin mundësi të qëndronin në një territor të caktuar, siç ishte grupi i punëtorëve nën Vojvodën Franciscus, të cilët i ishte lëshuar letra e sjelljes së sigurt nga Konti Thurzo më 20 shkurt, 1616:

“... ky fis zellshëm përpiqet, duke gabuar nga një vendbanim në tjetrin, duke mos ditur për pasuri as etje për lavdi, ushqim dhe veshmbathje, duke bërë punën e tyre çdo ditë dhe çdo orë në kudhër, shakull, çekanë apo pinca zjarri në qiell të hapur ... ne mendojmë se ky fis meriton dhembshuri dhe çdo favorizim, dhe kërkesë që u jepni – me kënaqësi – mundësinë për tu vendosur në periferitë tuaja, fushat dhe livadhet, për t’i vendosur tendat e tyre dhe të vazhdojnë me profesionin e tyre, dhe mënyrën e tyre të zakonshme të jetesës ...”

III. 3 (ekstraktuar dhe përkthyer nga Mayerhofer 1988, f. 17f.)

## LIGJET GJITHNJË E MË TË ASHPRA KUNDËR “CIGANËVE”

Fakti që romët akuzoheshin të ishin spiunë të turqve inicioi fazën e parë të “Persekutimit të Ciganëve” në Perandorinë e Shenjtë Romake në fillim të shekullit të 16-të. Ndalimet për hyrje ishin miratuar, dhe dënime drastike për kthimin e “Ciganëve” ishin urdhëruar. Romët u përpoqën të tërhiqen në vendet fqinje, në zonat pyjore dhe malore. Sidoqoftë, pas një kohe të shkurtë edhe vendet që kufizoheshin me Perandorinë e Shenjtë Romake shqiptuan sanksione ndaj “Ciganëve”. Më në fund, me një vonesë, të gjitha vendet e Evropës qendrore dhe perëndimore miratuan ligjet anti-“Cigane”. Ekzistojnë disa arsye pse ky vërshim i ligjeve nuk rezultoi në dëbimin e tërësisht të romëve nga Evropa në shekullin e 16-të. Së pari, makineria administrative

përgjegjëse për ekzekutimin e ligjeve vetëm në rastet e rralla përdorte ashpërsinë që kërkohet. Së dyti, disa anëtarë të fisnikërisë ende refuzonin t’i zbatonin urdhrat e sundimitarit të tyre dhe ofronin mbrojtje ndaj romëve; përveç kësaj, forca policore në asnjë mënyrë nuk punonte me po aq efekt siç punon në vendet moderne. Sidoqoftë, romët e dëbuar në qoshe vazhduan të kërkojnë mjetet për shmangien e persekutimit.


Fillimi i periudhës të vuajtjes së skajshme për romët shënohet nga një dekret i Maximilianit I, i cili urdhëroi të gjithë “Ciganët” të largohen nga territori i perandorisë deri në pashkët e vitit 1501. Pas këtij afati, ata konsideroheshin të paligjshëm, dhe mund të kapeshin dhe vriteshin nga secili qytetar. Jo efektiviteti i shumë masave rezultoi në ligjet e reja dhe gjithnjë e më të ashpra në të gjitha vendet evropiane. Vetëm në Perandorinë e Shenjtë Romake, 150 “dekrete për Ciganët” is-

hin miratuar në kohën prej vitit 1500 deri 1750 dhe ligjet e reja gjithmonë tejkalonin ligjet ekzistuese në aspektin e mizorisë. [III. 2]

## “NDJEKJET E CIGANËVE” NË SAKSONI

Në vitin 1579, zgjedhësi Augusti i Saksonisë urdhëroi që të gjitha pasaportat e atyre “verzweifelt los Gesellen” (shoqëruesve të shturur të dëshpëruar) të konfiskoheshin dhe shkatërroheshin. Në vitin 1688, zgjedhësi Wilhelm I i Brandenburgut miratoi një dekret sipas të cilit “as Ciganët as tregtia e tyre” nuk duhej të toleroheshin. Meshkujt ishin kërcënuar me punë të dhunshme (ndërtimi i kalave), femrat me fshikullimë dhe damkosje, dhe fëmijët me “konfiskim”. Në vitin 1711, Augusti II i Saksonisë i dha autoriteteve të tij lejen për të shtirë në “Ciganët” nëse






III. 4  
*Ky urdhër i oborrit francez i vitit 1612 urdhëron të gjithë "Egjiptasit" të braktisin mbretërinë franceze brenda dy muajve— një dokument në vargun e urdhrave të ekzekutuar në mënyrë të dobët lidhur me romët.*  
(nga Hancock 1987, f. 57)



III. 5 (Detaj)  
*Njoftimi paralajmërues për t'i kërcënuar romët, sikurse ishte shpallur në kufijtë e Perandorisë së Shenjtë Romake, c. 1715.*  
(nga Asséo, Henriette 1994: Les Tsiganes. Une destinée européenne. Paris: Gallimard, p. 37)



III. 6  
*Në "Premática" të vitit 1633 Filipi IV i Spanjës urdhëroi romët të hiqnin dorë nga gjuha e tyre dhe mënyra e mësuar e jetesës.*  
(nga Fraser 1992, f. 162)

ata do të rezistonin arrestin. Mbreti Friedrich Wilhelm I i Prusisë (1713-1740) në "Udhëzimet" e tij (1725) iu dha mundësinë autoriteteve të varin të gjithë "meshkujt dhe femrat Cigane" mbi moshën 18 vjeçare pa gjykim. [III. 1]

Në vitin 1734, Konti i Hesses ofroi gjashtë "Reichstaler" për secilin "Ciganë" që kapej i gjallë, dhe gjysmën e shumës për secilin Ciganë të vranë. Nxtjet e këtij lloji ishin në bazë të "Ndjekjeve famëkeqe të Ciganëve", gjatë të cilave romët ndiqeshin si gjah nga qytetarët. Në Saksoni, gjuajtjet e tilla quheshin "Kesseltreiben" dhe konsideroheshin si zbatimje publike.

Në territoret e trashëguara austriake romët nuk trajtoheshin më pak brutalisht sesa në pjesët tjera të Perandorisë së Shenjtë Romake. Vetëm në Hungari, më saktësisht në pjesët perëndimore të Hungarisë, që kishin qëndruar nën sundimin e Habsburgut

pas pushtimit turk, disa sundues lokal kishin tendencë të toleronin romët për aq kohë sa ata do të ishin të dobishëm. Për shembull, György Thurzo, Zyrтари i Perandorisë Hungareze, në vitin 1616 i mundësoi një grupi të romëve të vendoseshin në territorin e tij dhe të ushtronin punën e tyre si farkëtarë, që ishte e dobishme për fisnikërinë hungareze për luftë. [III. 3]

**FRANCA DHE HOLANDA:  
GALERAT DHE  
"NDJEKJET PAGANE"**

Në Francë, u deshën gati 150 vite derisa shtypja dhe persekutimi i romëve u vazhdua me të njëjtin vrull sikurse në Perandorinë e Shenjtë Romake. Sidoqoftë, kur Lui XIV miratoi ligjet e tij anti-"Cigane" në gjysmën e dytë të shekullit të 17-të, për shkak të centralizimit të fortë dhe kontrollit administra-

tiv, ato u zbatuan në mënyrë shumë më efikase sesa ligjet që kufizoheshin në zona të vogla të Perandorisë së Shenjtë Romake të fragmentuar.

Lui XII (1504), Francois I (1539) dhe Charles IX (1561) veçse kishin dëbuar "Ciganët" nga mbretëria e tyre. Një forcë joefektive policore, shkujdesi dhe inkonsekuenca e ekzekutimit të urdhrave mbretërore si dhe bujaria e disa anëtarëve të fisnikërisë në fillim i prishi qëllimet e mbretit. Vetëm në mes të vitit 1600 – e që ka të bëjë me ardhjen e absolutizmit – masat e autoriteteve u bën më të vrullshme dhe ndëshkimet më të ashpra. Tanimë në vitin 1666, Lui XIV dekretoi që të gjithë "Ciganët" meshkuj të arrestoheshin dhe të dërgoheshin në galera pa gjykim. Në vitin 1682 "Roi Soleil" konfirmoi dhe intensifikoi rregullat ekzistuese: romët meshkuj duhej të dënoheshin përjetësisht në galera, femrat duhej të sterilizohen dhe fëmijët duhej

të vendoseshin në streha varfanjakësh. Nëse ata ende nuk do të hiqnin dorë nga jeta vagabonde ata do të duhej të përballonin torturën, damkosjen dhe dëbimin. [III. 4]

Ajo çka ishte e veçantë për këto masa ishte fakti se romët madje nuk kishin nevojë të fajësoheshin për një vepër kriminale. Në Francë, sikurse në shumë vende tjera, të qenit “Ciganë” ishte një arsye e mjaftueshme për persekutimin e tyre. Fisnikët dhe gjykatësit që ofronin mbrojtjen e “Bohemëve” apo “Egjiptasve” kërcënoheshin me humbjen e juridiksionit të tyre dhe shpronësim nga mbreti. Në mënyrë që të shmangnin vëmendjen e autoriteteve, grupet më të mëdha të romëve u ndanë; shumë familje u vendosën së paku në një pjesë të vendit. Disa tentuan të gjejnë strehim në zonat kufitare– Alsace, Lorraine ose regjioni Bask – dhe në zonat tjera të ashpra.

Gjithashtu në Holandë, që praktikisht u pavarësua nga Spanja në vitin 1609, intensifikimi i vazhdueshëm i ligjeve në fillim mbeti jo efektiv. Vetëm kur provincat mundësuan më shumë të drejta për pushtetin qendror dhe arritën marrëveshje në mes të njëra tjetrës, një persekutim i koordinuar dhe efikas ishte i mundshëm. Gjatë këtij veprimi të rëndomtë dhe më mirë të organizuar nga forca policore, të ashtuquajturat “heiden-

jachten” (ndjekjet pagane) u bënë gjithnjë më intensive. Ato kryheshin me ndihmën e forcave ushtarake, madje ato ndodhën edhe në tokat fqinje të Gjermanisë, siç ishin dukatet e Kleve dhe Münster. Pas “heidenjacht” të fundit, të kryer në vitin 1728, shumica e viktimizeve ose ishin vvarë, kishin ikur, ose iu kishin nënshtuar urdhrave të autoriteteve.

#### ASIMILIMI I DETYRUAR: SIUJDHESA IBERIANE

Spanja ishte vendi i vetëm evropian që me radhë– dhe me pasojë – ndoqi zhdukjen dhe asimilimin e plotë të romëve. Filipi III, në vitin 1619, i urdhëroi të gjithë “Egipcianos” të braktisin vendin, me kërcënim për dënim me vdekje. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë ai iu mundësoi të qëndronin nëse do të vendoseshin dhe hiqnin dorë nga mënyra e mësuar e jetesës. Në “Premática” e tij (1633) Filipi IV u ndaloj “Egipcianos” të jetonin në grupe të vogla, të përdornin gjuhën e tyre, dhe të visheshin ndryshe nga spanjollët. Shkelja e këtij ligji dënohet me gjashtë vjet në galerë, me fshekullim ose dëbim. [III. 6]

Deri në mesin e shekullit të 18-të, procesi “Gitanos” spanjoll për tu vendosur tanimë kishte shkuar shumë larg, por në asnjë mënyrë nuk ishte

një asimilim i plotë. Romët refuzuan t’i përmbushnin disa kërkesa të Mbretit Ferdinand, kështu që ai mori një vendim radikal: Mëe 30 qershor të viti 1749 të gjithë romët duhej të mblidheshin në tërë Spanjën dhe të shfrytëzoheshin për punë të detyruar në minierat e shtetit, në kantiere detare, dhe fabrika. Në këtë ditë, që hyri në historinë e Spanjës si “E mërkura e zezë”, përafërsisht 9,000 – 12,000 romë ishin internuar.

Portugalia, sikurse Britania e Madhe më vonë, gjeti një mënyrë të re për tu marrë me “Ciganët” dhe tanimë në vitin 1538, ishin dëbuar romët për në Afrikë ose Brazil, ku romët ishin në mesin e ardhësve të parë evropian.

Për më tepër se 300 vjet, persekutimi dhe përjashtimi ishin dominues në trajtimin e romëve nga autoritetet përgjatë tërë Evropës. Pavarësisht nga dënimet mizore, masat që ishin ndër-marrë në shekujt 16-të dhe 18-të për të zgjidhur “problemin e supozuar të Ciganëve” nuk kishin efektin e dëshiruar dhe në asnjë mënyrë nuk arritën “zhdukjen” e “Ciganëve”. Ky fakt, ndikimi i Iluminizmit dhe parimet e politikës absolutiste sociale dhe financiare i bëri sunduesit evropian të gjejnë mënyra të reja në “politikën e tyre për Ciganët”. Habsburgët në Austri, dhe Burbonët në Spanjë, në veçanti, filluan një asimilim më pak mizor, por njëloj të pamëshirshëm, të romëve.

#### Bibliografia

**Fraser, Angus (1992)** *The Gypsies*. Oxford / Cambridge: Blackwell | **Gilsenbach, Reimar (1994)** *Weltchronik der Zigeuner. Teil 1: Von den Anfängen bis 1599*. Frankfurt am Main: Peter Lang | **Gronemeyer, Reimer / Rakelmann, Georgia A. (1988)** *Die Zigeuner. Reisende in Europa*. Köln: DuMont | **Hancock, Ian (1987)** *The Pariah Syndrome. An Account of Gypsy Slavery and Persecution*. Ann Arbor, Michigan: Karoma | **Kenrick, Donald (2004)** *Gypsies: From the Ganges to the Thames*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Mayerhofer, Claudia (1988)** *Dorfzigeuner. Kultur und Geschichte der Burgenland-Roma von der Ersten Republik bis zur Gegenwart*. Wien: Picus | **Tcherenkov, Lev / Laederich, Stéphane (2004)** *The Rroma. Volume I. History, Language and Groups*. Basel: Schwabe | **Vossen, Rüdiger (1983)** *Zigeuner. Roma, Sinti, Gitanos, Gypsies zwischen Verfolgung und Romantisierung*. Frankfurt am Main: Ullstein



© Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjete, elektronike (CD-Rom, Internet, etj.) ose mekanike, përfshirë fotokopjimi, incizimi apo sistemi i ruajtjes ose mbajtjes së informatave, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i Botimit, Drejtoria e Komunikimit (F-67075, Strasbourg cedex ose publishing@coe.int)



PROJEKT PËR EDUKIMIN E  
FËMIJËVE ROMË NË EVROPË  
<http://www.coe.int/education/roms>

[romani] PROJECT <http://romani.uni-graz.at/romani>